



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**  
**Nr. 106, datë 24.07.2014**

**PËR**  
**MASA KORRIGJUESE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**ANSIG SH.A. NGA ANALIZA E VITIT 2013 DHE TREMUJORIT**  
**TË PARË TË VITIT 2014**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21) si dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 149, pikës 1), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit, dhe risigurimit “ me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E :**

Shoqëria “Ansig” sh.a. ka kryer veprimtarinë e sigurimit gjatë vitit 2013 dhe 31.03.2014 bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Analiza e gjendjes financiare më 31.12.2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014, e shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a., është kryer mbi bazën e pasqyrave financiare të raportuara në AMF. Referuar konkluzioneve të analizës financiare rezulton si më poshtë:

- Aftësia paguese e shoqërisë për periudhën 31.12.2013 është në masën **270,803,000 lekë** dhe për periudhën 31.03.2014 është në masën **325,724,412 lekë**. Pra *shoqëria nuk zotëron aftësi paguese në të dyja periudhat* në kundërshtim me kërkesat e nenit 96 e vijues të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.
- Aktivitetet e Përshtatshme në mbulim të Provigjoneve Teknike për periudhën 31.12.2013 mbulojnë **47.04%** të totalit të Provigjoneve, dhe për periudhën 31.03.2014 mbulojnë **53.52%** të P.T. Pra shoqëria nuk zotëron Aktive të përshtatshme të mjaftueshme në mbulim të Provigjoneve Teknike në shkelje të nenit 103 të Ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004, e konsideruar shkelje e rëndë e rregullave të menaxhimit të rrezikut sipas germës d) të pikës 3 të nenit 126 të Ligjit të mësipërm;  
Në zbatim të vendimit të Bordit nr. 127, datë 23.12.2013, shoqëria “Ansig” sh.a., është urdhëruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve dhe t’i propozojë rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet investimeve të reja, brenda 3 muajve nga data e marrjes së këtij vendimi. Shoqëria në zbatim të këtij vendimi ka rritur kapitalin themeltar në vlerën 74,300,000 lekë por kjo rritje rezulton e pamjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të Vendimit të Bordit.
- Raporti i shpenzimeve për periudhat 31.12.2013 dhe 31.03.2014, ka pasur një tendencë në rritje duke tejkaluar parametrat optimalë;

- Referuar nivelit të aftësisë paguese rezulton se shoqëria merr në risigurim përgjegjësi që tejkalon mbulimin maksimal të saj, në kundërshtim me nenin 107 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Referuar konkluzioneve të analizës financiare për shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, të ngjashme me parashikimet e ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, masat e mbikëqyrjes për shkeljet e mësipërme bazohen në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Shoqëria “Ansig” sh.a, ndodhet në rrethanat e përcaktuara në nenin 150, pika 1), germa c), d) dhe i), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

## **V E N D O S I:**

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) germa b) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” nxjerrjen e urdhërit për shoqërinë “Ansig” sh.a., për eliminimin e shkeljeve dhe të parregullsive, të dispozitave të nenit 150, pika 1), germa c), d) dhe i) si dhe nenit 151, germa a), d) dhe e) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si më poshtë:
  - a) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, për të zbatuar një plan veprimi, i cili garanton nivelin e fondit të garancisë;
  - b) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pika 1, germa c) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të asamblesë dhe t’i propozojë marrjen e vendimeve përkatëse;
  - c) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pika 1, germa e), nëndarja i) dhe viii) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, përmirësimin e procedurave të administrimit të rrezikut si dhe marrjen e çdo mase tjetër të nevojshme për zbatimin e rregullave të menaxhimit të rrezikut.
2. Bazuar në nenin 153, pika 3) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, shoqëria të paraqesë një plan biznesi, brenda datës 30.09.2014, i cili reflekton masat e duhura korrigjuese të cilat do të korrigjojnë problemet e mësipërme.
3. Bazuar në nenin 153, pika 4), dhe nenin 154, pika 1) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, shoqëria Ansig sh.a., të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë dhe të depozitojë në Autoritet një raport brenda datës 31.12.2014.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**